



Vendimi Nr.98/ 23
Datë: 03.11.2023

Duke u bazuar në nenin 11 par. 3.1, nenët 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 par. 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 03.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e aseteve që i përkasin divizionit të Turbinave me Gas, nga CSIC Longjiang GH Gaz Turbine Co. Ltd, Kinë dhe Guanghan Gas Turbine GmbH, Gjermani si dhe Guanghan Gas Turbine Zvicër AG (blerës) dhe/mbi MAN Energy Solutions, SE Gjermani dhe MAN Energy Solutions Zvicër AG (shitës).

Blerësi I. CSIC Longjiang GH Gas Turbine Co. Ltd, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e organizuar sipas ligjeve në fuqi të Kinës, me adresë të regjistruar Nr. 31, rruga Honghu Yingbin Road Concentration Area, Harbin High – Tec, zona e zhvillimit industrial Kinë, e regjistruar pranë distriktit të (Administratës së Qarkut Songbei) për rregullimin e tregut me numër të unifikuar të kodit të kreditit socialë 9123019906368477X2, që mban drejtpërdrejt ose tërthorazi të gjitha aksionet në blerësin II.

Blerësi II. Guanghan Gas Turbine GmbH, është një shoqëri Gjermane me përgjegjësi të kufizuar (GmbH) e organizuar sipas ligjeve të Gjermanisë me selinë e saj të korporatës në Oberhausen, me adresë Günther-Büch-Straße 28, 46049 Oberhausen, Gjermani e regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur në gjykatën lokale (Amtsgericht) të Duisburgut sipas HRB 36175.

Blerësi III. Guanghan Gas Turbine Zvicër AG, është një korporatë aksionare (Aktiengesellschaft) e organizuar sipas ligjeve të Zvicrës me selinë, c/o Format A AG, Wiesenstrasse 9, 8008 Cyrih, Zvicër, e regjistruar në regjistrin tregtar (Handelsregisteramt) të Kantonit të Cyrihut nën CHE-183.909.121. Pas një analize strategjike të ndarjeve të tij të biznesit, Shitësi I synon të heqë biznesin e tij të turbinave me gas.

Shitësi I. MAN Energy Solutions, SE, është një Korporatë Evropiane e Aksioneve (Societas Europaea) e organizuar sipas ligjeve të Gjermanisë me selinë e saj të regjistruar (Sitz) me adresë Stadbachstralle 1. 86153 në Augsburg, Gjermani dhe e regjistruar në regjistrin tregtar (Handelsregister) të mbajtur në gjykatën lokale (Amtsgericht) të Augsburgut sipas HRB 22056. Aktiviteti i biznesit; është prodhues prijës i motorëve me naftë, turbo makinerive dhe pajisjeve të Termocentraleve.

Shitësi II. MAN Energy Solutions Zvicër AG, është një Korporatë aksionare Zvicerane (Aktiengesellschaft) e organizuar sipas ligjeve të Zvicrës me selinë e saj të regjistruar në Hardstrasse 319, 8005 Cyrih, dhe e regjistruar në regjistrin tregtar të mbajtur në zyrën e regjistrimit tregtar (Handelsregisteramt) të kantonit të Cyrihut nën CHE-108.814.277 dhe është regjistruar për qëllim të TVSH- së në Zvicër. Shitësi I është aksionarë i vetëm i shitësit II.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja gjashtë mijë Euro.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 11.09.2023 me Nr.Prot. 437/23-01/H ka pranuar kërkesën për Përqendrim, lidhur me blerjen e asetëve që i përkasin divizionit të Turbinave me Gas, nga CSIC Longjiang GH Gaz Turbine Co. Ltd, Kinë dhe Guanghan Gas Turbine GmbH, Gjermani si dhe Guanghan Gas Turbine Zvicër AG (blerës) dhe/mbi MAN Energy Solutions, SE Gjermani dhe MAN Energy Solutions Zvicër AG (shitës).

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 06.09.2023.
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 09.09.2023
4. Parashtruesi i kërkesës dhe shitësit kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen për blerjen asetëve të lidhur me datë 19.06.2023.

Baza juridike;

Sipas nenit 13, të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që;

- a) Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë më 20,000,000 Euro.
- b) Qarkullimi i një palë në Përqendrim e kalon shumë më 1,000,000 Euro. (Bazuar në Deklaratën e Parashtruesit të Kërkesës)
- c) Parashtruesit e kërkesës kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen për blerjen e asetëve të lidhur me datë 19 Qershor 2023.
- d) Kërkesa për përqendrim, është bërë për arsye se Aplikuesi përmes filialeve të saj ka qarkullim përmes shitjes në Kosovë.

Analiza e Konkurrencës

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Tregu relevant:

Tregu gjeografik - do të konsiderohet Republika e Kosovës, (*Bazuar në Deklaratën e Parashtruesit të Kërkesës*).

Tregu i Produktit - është tregu i Turbinave me Gas.

Transaksioni i propozuar, do të realizohet në tregun gjeografik të Gjermanisë lidhur me blerjen e asetëve mbi kompaninë MAN Energy Solutions, SE Gjermani dhe MAN Energy Solutions Zvicër AG, të cilat operojnë në sektorin e turbinave me gas në shtetet; Zvicër dhe Gjermani, të njëjtat nuk kanë ndonjë prezencë në Kosovë, qoftë degë apo përmes shitjeve, ndërsa pala blerëse është prezent përmes shitjeve (indirektë), në Republikën e Kosovës (Deklarata e Blerësit).

Sipas vlerësimit të kërkesës, Përqendrimi i ndëmmarrjeve, nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg dhe si i tillë, nuk ndikon në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese në Republikën e Kosovës.

Shënim; Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurrese, do të jetë nën monitorimin, e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës. Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Obligohet Sekretariati, që të kujdeset për zbatimin e këtij, Vendimi

KOMISIONI I AUTORITETIT TË KONKURRENCES

Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare

A blue ink signature of Kaltrina Sela.

Florent Mehmeti
Anëtar

A blue ink signature of Florent Mehmeti.

Nafije Osdautaj
Anëtare

A blue ink signature of Nafije Osdautaj.

Salihe Gashi-Loku
Anëtare

A blue ink signature of Salihe Gashi-Loku.

Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva